

Fëmija në qendër të vëmendjes



**Grupi i lojës – Pika
informative për prindërit**

Pikat kryesore

Në **GRUPET E LOJËS** takohen një deri në tri herë në javë (për 2 deri 3 orë) për lojë të lirë, për punë dore, këndim, për të dëgjaur tregime dhe për të eksperimentuar të shumtën 10 fëmijë të moshës nga 3 vjeçare deri në moshën e kopshtit.

GRUPET E LOJËS janë grupe konstante dhe të vijueshme. Dallojnë nga çerdhet sa i përket kohëzgjatjes, kufirit të moshës, qëllimeve dhe bashkëpunimit të prindërve.

GRUPET E LOJËS ju ofrojnë fëmijëve dhe prindërve kontakte dhe impulse të reja në një botë të zgjeruar të kontakteve dhe të përvojave.

Dy parime bazë të rëndësishme të **grupeve të lojës** janë: «Më ndihmo ta bëj vetë» (Maria Montessori) dhe «Ta bësh vetë të krijon vetëbesim» (Lucie Hillenberg)

GRUPET E LOJËS udhëhiqet nga një drejtuese e shkolluar e grupeve të lojës. Ajo ndihmohet nga ndonjë prej prindërve (në mënyrë ciklike), nga një praktikante ose nga një drejtuese e dytë (në grupin prej 6 deri 10 fëmijë preferohen 2 drejtuese të lojës).

Bartëse të **grupeve të lojës** janë shoqatat, bashkitë (kishtare) ose firma të ndryshme.

Në konceptimin e grupit të lojës hyn edhe bashkëpunimi i ngushtë me prindërit.

GRUPET E LOJËS financohen edhe më tej kryesisht nga kontributet e prindërve. Pjesërisht ndihmohen nga bashkitë (kishtare).

GRUPET E LOJËS në pyll nuk kanë mure e as kulm – ato përfitojnë nga vendi i lojës në natyrë (rekomandim: deri në 8 fëmijë dy drejtuese të grupit; 8–12 fëmijë tri drejtuese).



Pikë për pikë...

Loja: Loja e lirë është në qendër të çdo grupi të lojës. Të luash do të thotë të zbulosh, të provosh, të përpunosh, të gjesh ligjshmëri, ta ndiesh realitetin dhe ta provosh atë në fantazi, shkurt: të mbledhësh forca për jetë.

Programi: jo, program fiks mësimor në grupet e lojës nuk ka. Në vend të programit ekzistojnë parime bazë. Këto rekomandojnë provimin e mundësive të shumta dhe të materialit të shumtë të këndimit, të punëdores, të ngjyrosjes, të marrjes me muzikë, të lëvizjes dhe të luarjes teatër.

Integrimi: Edhe fëmijët me gjuhë të huaj amtare si dhe fëmijët me nevoja të veçanta kanë vend në grupet e lojës. Ata aty gjejnë »Gspänli« (»dhuratëz«), e mësojnë gjuhën e re dhe mësohen ta shohin veten si pjesë e grupit. Kjo është një gjë e mirë jo vetëm për fëmijët, por edhe për prindërit e tyre. Për shumë prej tyre është hapi i parë i daljes nga izolimi.

Përjetimet: Gatimi i përbashkët i bukës, ndërtimi i një pingu, ngjyrosja e sipërfaqeve të mëdha. Futja e duarve thell në argjilë. Pas një grindjeje të fortë, leximi i përbashkët i një libri të ilustruar. Pasi të vdesësh nga të qeshurit, të shkosh në »Gumpiecke« (këndin e kërcimit) dhe ta kurdisësh me mjeshtëri një betejë me jastëkun. Në një sheti të mbledhësh gjethe të ngjyrave të ndryshme dhe të sodisësh lopët.

Argjila, zalli, brumi, dheu, uji, kashta, druri: fëmijët e vegjël e përceptojnë botën si të tërë, me të gjitha shqisat. Ata ndijojnë, prekun, nuhasin, dëgjojnë, shohin, shijojnë – dhe i memorojnë përceptimet e tyre. Grupi i lojës ju ofron atyre një festë shqisash.

Dinamika grupore: Frekuentimi në grup dhe bindja se mëson, i ndihmon fëmijës. Të pranosh mendimet e të tjerëve dhe ta mbrosh mendimin tënd është një gjë që kërkon ushtrim. Në grupin e lojës, fëmijët gjejnë një rreth ideal të sjelljes sociale. Prindërit bashkëpunues i sjellin fëmijës një përvojë të mëtejme të sjelljes me të rriturit.

Luajtja e roleve: Të guxosh të jesh njëherë «luan» dhe të ulërish frikshëm. Si macje e vogël të tërheqësh vëmendjen e të tjerëve. Të veshesh si fantazmë dhe t'i trembësh të tjerët me masë: në lojë fëmija i përpunon të gjitha përjetimet e tij dhe i vë në provë me dëshirë të madhe të gjitha faqet e personalitetit të tij. Mirë, në grupin e lojës ka shumë rrecka për të veshur – dhe shumë fëmijë për të luajtur.

Pashmangshmëria: Grupet e lojës janë bërë që moti të domosdoshme. Familjet e vogla, trafiku i shtuar dhe mjedisi i ngarkuar janë në kundërshtim me shtytjen e brendshme të fëmijëve për lëvizje dhe zbulimin e së panjohures. Për këtë arsye grupet e lojës janë një «ishull» i mirëseardhur: aty fëmijët mund të bëjnë atë që për zhvillimin e tyre të tërësishëm është i domosdoshëm.

Proces në vend se produkt: punimet e dorës, që fëmija i sjell nga grupi i lojës në shtëpi, të rriturve mund t'ju duken marrëzira. Por, për fëmijët janë vepra të bëra vetë nga A deri në ZH – me përkushtimin, koncentrimin dhe idetë e veta. Grupi i lojës nxit procese kreative – ai nuk kërkon produkte të finalizuara.

Preventiva: Përmes vështrimit të saktë, drejtuesja e grupi të lojës vëren vonesat e mundshme në zhvillim, gjërat që bien në sy dhe nevojat e veçanta të fëmijës. Së bashku me prindërit dhe, sipas nevojës, me ndihmën edhe të një personi profesionist mund të ndërmerren edhe hapa të tjerë dhe atë në kohën kur problemet ende nuk janë manifestuar.

Bashkëpunimi i prindërve: Bashkëpunimi i prindërve nuk është askund më intensiv se sa në grupet e lojës, sepse fëmijët e grupit të lojës janë kufikaluesit e dy botërave: sa më i mirë të jetë kontakti mes familjes dhe grupit të lojës, aq më mirë ndihen fëmijët në të dy botërat- dhe aq më i lehtë ju duket atyre hapi i bërë jashtë.

Pika orientuese



Si e gjejmë një grup të lojës?

Adresat mund të gjenden tek këshillimoret për nëna dhe baballarë, pranë sekretariateve dhe enteve të të rinjve si dhe pranë komunave ose zyrave regjionale profesionale dhe kontaktuese të grupeve të lojës: www.spielgruppe.ch

Si e njoh kualitetin e një grupi të lojës?



Karakteristikat e jashtme kualitative janë:

- Madhësia e grupit (maksimalisht 10 fëmijë)
- Shkollimi dhe shkollimi i mëtejshëm i drejtueses së grupit të lojës
 - Sipërfaqja e hapësirës prej rreth 60m² (përfshirë objektet përcjellëse)
 - Drejtuesja e dytë (me ndihmën e një prindi, një praktikanteje ose të drejtueses së dytë)
- Transparenca dhe garantimi i kushteve të përgjithshme (kontabiliteti, sigurimet etj)

Karakteristikat e brendshme janë:

- A shkon fëmija me qejf në grupin e lojës?
- A kultivohet sjellje me konsideratë dhe me ndjenja?
- A e nxit drejtuesja e grupit të lojës bashkëpunimin me prindërit?
- A ndihemi ne prindërit mirë në kontaktet me drejtuesen e grupit të lojës?



Çka mëson fëmija im në grupin e lojës?

Mëson si të silllet në një grup: të luajë me fëmijët e tjerë, të grindet, të qesh, të flasë, të festojë. Mëson të njohë materiale të reja dhe të mbledhë një sërë përvojash shqisore. Ai hyn në një fushë të re të përjetimeve aktive dhe krejt personale. Ai ka rastin ta mësojë ndarjen nga nëna dhe babai duke qenë i mbikëqyrur.



Çka ju sjell grupi i lojës prindërve?

Edhe prindërit përfitojnë nga grupi i lojës: ata vendosin kontakte të reja, ata e njohin fëmijën e tyre në grup. Në biseda me drejtuesen e grupit të lojës ata marrin një pasqyrë të plotë për fëmijën e tyre, mund të parashatrojnë pyetje dhe t'i diskutojnë problemet. Dhe ata kanë mundësi, falë grupit të lojës, jo vetëm një herë të futen në një botë plot fantazi dhe kreacion.

Përfundim

«Fëmijëve ju duhet uji, balta, shkurrestet, shtazët dhe vendi ku mund të luajnë. Ata mund të rriten edhe pa të gjitha këto dhe me tepihë, shatzë stofi ose me rrugë apo oborre të asfaltuara. Ata mbijetojnë, por mos të habitemi nëse më vonë nuk mund t'i mësojnë kurrë gjërat themelore sociale.»

Alexander Mitscherlich (1908 bis 1982)

Pikë.

Të gjitha gjërat e rëndësishme që duhet t'i dini mbi grupet e lojës mund t'i gjeni në: www.spielgruppe.ch

Ekzemplarë të tejrë mund të porosisni në:
IG Spielgruppen Schweiz
Im Schörli 1
CH-8600 Dübendorf
Telefon 044 822 02 21
laden@spielgruppe.ch



Përktheu: Hava Shala – Gerguri (shqip)

Pädagogische Fachberatung: Esther Meier, Winterthur
Text und Konzept: Franziska Hidber, Textatelier silberfeder, Wil
Gestaltung: Boni Zimmermann, bzDESKTOP, Hombrechtikon